



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:205750  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05709445

**C.nr.432/17**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. G. nga S., të cilat sipas autorizimit nga shkresat e lëndës e përfaqëson Av. Kastriot Memaj nga Suhareka, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “INSIG” Sh.A.-dega në Kosovë me adresë rruga “UÇK” nr.240 Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi material”, vlera e kontestit 3,200.00 (tremijë e dyqind) euro, jashtë seancës me datë 20.05.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore me shenjën C.nr.432/17 e datës 13.12.2017, për shkak të hapjes së procedurës së likuidimit të detyrueshëm ndaj të paditurës “Insig” Sh.A. me seli në Prishtinë.
- II.** Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdoj kur përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e merr përsipër procedurën, apo kur t’a thërrasë gjykata ta bëjë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësi F. G. nga S., të cilin sipas autorizimit në shkresat e lëndës e përfaqëson Av. Kastriot Memaj nga Suhareka, me datë 13.12.2017 ka parashtruar padi në këtë gjykatë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimit “INSIG” Sh.A. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi material”, vlera e kontestit 3,200.00 euro.

Gjykata zyrtarisht është informuar se siguruesit “INSIG” Sh.A. i është revokuar licenca Nr.003 e datës 25 mars 2002 nga Autoriteti Bankar dhe i pagesave të Kosovës, paraardhës ligjor i Bankës Qendrore të Kosovës.

Gjithashtu ndaj siguruesit “IINSIG” Sh.A. janë hapur procedurat e likuidimit të detyrueshëm sipas kapitullit XVIII të ligjit për sigurimet nr.05/L-045 për sigurimet, dhe bazuar në vendimin nr.23-10/2019, z.P. L. emërohet Likuidator i Siguruesit “Insig” Sh.a, Dega Kosovë.

Me rastin e vënies në dijeni të këtij fakti, gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika d) të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”,* ndërsa me nenin 280, paragrafi 1 të po këtij ligji, është paraparë se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, pika a) - d) të këtij ligji, do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”.*

Gjykata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpriten edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund kryej kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhimit eventual të procedurës.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se e paditura është në procedurën e likuidimit të detyrueshëm, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.432/17, datë 20.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.